REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 879/20
Datë/Datum. 02.11.20

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KOMUNA E VUSHTRRISË**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr[1] i prokurimit	**VU644-20-4423-5-1-1**
Nr i brendshëm	**Vu644-20-050-5-1-1**

Sa i përket tenderit për: Asfaltimi i rrugëve në lokale në fshatra sipas Lot 1 dhe Lot 2

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

"HAXHA KOM"

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Skenderaj

(Adresa)

Skenderaj ***42000***

(Vendi)(Kodi postar)

044-214 176

(Numri Telefonit)(Numri i Faks-it)

Haxhi Zenullahi

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

haxhakom@hotmail.com

(Adresa elektronike)

02.11.2020

(Data e parashtrimit të ankesës)

"HAXHA KOM" N.N. INSTALUESE NDËRTIM I ULTE SKENDERAJ

(Nënshkrimi dhe vula)

[1] Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit) (Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës) (Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" apo "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Njoftimi për Kontratë:13.08.2020
Data e hapjes së ofertave: 17.09.2020
Letra standarde për tenderues të pasuksesshëm: 13.10.2020
Kërkesa për rishqyrtim:16.10.2020
Nuk kemi pranuar vendim për refuzim të kërkesës.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit? A keni bërë ndonjë reagim me shkrim dhe/ose kërkuar sqarime shtesë nga AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj, si dhe a u është përgjigjur me shkrim AK në lidhje me këtë? Nëse po, ofroni shkurtimisht detaje mbi këtë fakt:

Po [X] **Jo** [ ]

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [X] **Jo** [ ]

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së
Neni 60 i LPP-së
Neni 61 i LPP-së
Neni 64 i LPP-së
Neni 69 i LPP-së
Rregullorja për Çmime Jo-normalisht të Ulëta.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Të nderuar ne kemi pranuar njoftimin mbi vendimin e AK-së me dt.13.10.2020, ku për Lot 1 ka rekomanduar për kontratë OE "Kosova Asfalt" sh.p.k & "Alfa.i" sh.p.k, ndërsa për Lot 2 ka rekomanduar për kontratë OE "Bujar Shabani B.I" & "Agim Morina B.I", ndërsa neve na ka shpallur si tenderues i pasuksesshëm me arsyetimin se nuk e kemi dorëzuar tenderin me çmimin më të ulët për të dy lotet.

Fillimisht ju sqarojmë se AK-ja ka rekomanduar për kontratë për Lot 1 një OE i cili është i papërgjegjshëm për arsyet si në vijim:

OE i rekomanduar për kontratë për Lot 1 është dashur të shpallet si tenderues i eliminuar dhe jo të rekomandohet për kontratë pasi që ka ofertuar më çmim jo normalisht të ulët, ky fakt ilustrohet si në vijim, ku shihet që oferta e OE të rekomanduar për kontratë i plotëson të tri kushtet e parashikuara me rregulloren për çmime jo normalisht të ulëta.

Nr.				
	A	B	C	D
1	**kushti 1 -** është përmbushur kushti i pare sepse janë pranuar 12 oferta	**Pranuar 12 oferta**		
2		1. Kosova Asfalt SHPK & Alfa.i SH.P.K	465,346.85€	
3		2. Gurëbardhi SH.P.K & SABA BELCA & Construction sh.p.k	828.962.45€	
4		3. Haxhi Zenullahi BI & Mirusha Company SHPK	486.917.93€	
5		4. Bujar Shabani BI; Agim Morina BI	506.645.83€	
6		5. Eskavatori SHPK; Best Company SHPK	832.813.73€	
7		6. Sallahu SHPK	697.696.24€	
8		7. ILEA GR SHPK	745.213.16€	
9		8. Bejta Company	850.849.06€	
10		9. Benita Asfalt Group	815022.45€	
11		**Total (C2+C3+C4+C5+C6+C7+C8+C9+C10)**	**6,229,467.70€**	
12		**mesatarja (C11/9)**	**692,163.08€**	
13		**pragu 30% (mesatarja /1.3)**	**207,648.92€**	
14			**484,514.15€**	ne këtë rast oferta me nr. 1 përmbush edhe kushtin e trete

Pra duke u bazuar në tabelën e lartcekur shihet qartë se OE i rekomanduar për kontratë është dashur të eliminohet nga ky aktivitet i prokurimit pasi që në bazë të tabelës shihet qartë se OE i rekomanduar për kontratë ka ofertuar me çmim jo-normalisht të ulët.

AK-ja me vendimin e saj nuk e ka respektuar nenin 61 të LPP-së në lidhje me tenderët jo-normalisht të ulët, ku ceket qartë se *Nëse një operator ekonomik e dorëzon një tender që, është ose duket të jetë jo-normalisht i ulët, autoriteti kontraktues do të dërgojë një kërkesë me shkrim tenderuesit ku kërkohet nga tenderuesi që të dorëzojë me shkrim : (i) një ndarje të elementeve përbërëse të tenderit dhe (ii) shpjegime në lidhje me bazën e tenderit, sipas paragrafin 2. të këtij neni.*

Pra AK-ja nuk i ka zbatuar dispozitat e lartcekura të nenit 61 të LPP-së pasi që nuk ka kërkuar fare sqarime shtesë në lidhje me çmimin e OE të rekomanduar për kontratë, mirëpo vetëm e ka rekomanduar për kontratë, duke e favorizuar OE të rekomanduar për kontratë dhe duke na diskriminuar neve si OE i përgjegjshëm në këtë aktivitet të prokurimit.

Gjithashtu AK-ja e ka rekomanduar për kontratë një OE i cili është i papërgjegjshëm për faktin se nuk i ka përmbushur të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë përkatësisht kërkesat tek kapaciteti teknik dhe profesional pasi që OE i rekomanduar për kontratë marrëveshjen për zhavorr të lidhur me Guri Company sh.p.k nuk e ka ofruar të noterizuar, mirëpo e ka ofruar kopje të noterizuar.

Gjithashtu OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm edhe për faktin se nuk e ka përmbushur kërkesën e FDT-së ku kërkesë ka qenë se *"Operatori Ekonomik duhet te këtë Gurëthyes te licencuar ne pronësi apo marrëveshje për furnizim me zhavorr"* ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar *"Duhet të dëshmohet kopja e Licencës leje për aktivitete te veçanta , valide dhe e vlefshme e lëshuar nga Agjencia për Miniera dhe Minerale. Vëmendje! Ne rast se OE nuk posedon licencën, duhet ofruar Marrëveshjen për furnizim me OE te licencuar. Bashkangjitur duhet te jete Licenca e OE.* ***Marrëveshja duhet te jete e noterizuar ne mes te qiramarrësit dhe qiradhënësit në marrëveshjen e lidhur në mes të OE të rekomanduar për kontratë dhe Guri Company sh.p.k."***

OE i rekomanduar për kontratë për Lot 1 është i papërgjegjshëm për faktin se nuk e ka ofruar marrëveshjen e noterizuar në mes të blerësit (Kosova Asfalt sh.p.k) dhe shitësit (Guri Company sh.p.k), ashtu siç është kërkuar në kërkesën e lartcekur. Ky fakt mund të vërtetohet shumë lehtë nëse shikohet marrëveshja e noterizuar, vërehet se nuk është e noterizuar në mes të OE të rekomanduar për kontratë dhe Guri Company sh.p.k, pasi që personi i kompanisë në fjalë nuk figuron në noterizimin e prezantuar nga OE i rekomanduar për kontratë andaj edhe është dashur të shpallet i papërgjegjshëm. Në noterizim shkruan se prezent ka qenë vetëm z.Valdrin Shabani përfaqësues i OE të rekomanduar për kontratë, ndërsa nuk ka qenë prezent fare përfaqësuesi i kompanisë Guri Company sh.p.k, ku edhe shihet qartë në noterizimin e prezantuar nga OE i rekomanduar për kontratë, ku nuk figuron fare përfaqësuesi i kompanisë Guri Company.

Andaj duke u bazuar në faktet e lartcekura shihet qartë se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm dhe është dashur të eliminohet nga ky aktivitet i prokurimit dhe jo të rekomandohet për kontratë për Lot 1.

Ndërsa për Lot 2 AK-ja e ka rekomanduar për kontratë OE "Bujar Shabani B.I" & "Agim Morina B.I" OE ky i cili është i papërgjegjshëm për faktin se nuk i ka përmbushur të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë përkatësisht kërkesat tek kapaciteti teknik dhe profesional pasi që OE i rekomanduar për kontratë marrëveshjen për zhavorr të lidhur me Guri Company sh.p.k nuk e ka ofruar të noterizuar, mirëpo e ka ofruar kopje të noterizuar.

Gjithashtu OE i rekomanduar për kontratë për Lot 2 është i papërgjegjshëm edhe për faktin se nuk e ka përmbushur kërkesën e FDT-së ku kërkesë ka qenë se *"Operatori Ekonomik duhet te këtë Gurëthyes te licencuar ne pronësi apo marrëveshje për furnizim me zhavorr"* ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar *"Duhet të dëshmohet kopja e Licencës leje për aktivitete te veçanta, valide dhe e vlefshme e leshuar nga Agjencia për Miniera dhe Minerale. Vëmendje! Ne rast se OE nuk posedon licencën, duhet ofruar Marrëveshjen për furnizim me OE te licencuar. Bashkangjitur duhet te jete Licenca e OE.* ***Marrëveshja duhet te jete e noterizuar ne mes te qiramarrësit dhe qiradhënësit në marrëveshjen e lidhur në mes të OE të rekomanduar për kontratë dhe Guri Company sh.p.k."***

OE i rekomanduar për kontratë për Lot 2 është i papërgjegjshëm për faktin se nuk e ka ofruar marrëveshjen e noterizuar në mes te blerësit ("Bujar Shabani" B.I.) dhe shitësit (Guri Company sh.p.k), ashtu siç është kërkuar në kërkesën e lartcekur. Ky fakt mund të vërtetohet shumë lehtë nëse shikohet marrëveshja e noterizuar, vërehet se nuk është e noterizuar në mes të OE të rekomanduar për kontratë dhe Guri Company sh.p.k, pasi që personi i kompanisë në fjalë nuk figuron në noterizimin e prezantuar nga OE i rekomanduar për kontratë andaj edhe është dashur të shpallet i papërgjegjshëm. Në noterizim shkruan se prezent ka qenë vetëm z.Bujar Shabani përfaqësues i OE të rekomanduar për kontratë, ndërsa nuk ka qenë prezent fare përfaqësuesi i kompanisë Guri Company sh.p.k, ku edhe shihet qartë në noterizimin e prezantuar nga OE i rekomanduar për kontratë, ku nuk figuron fare përfaqësuesi i kompanisë Guri Company.

Andaj duke u bazuar në faktet e lartcekura shihet qartë se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm dhe është dashur të eliminohet nga ky aktivitet i prokurimit dhe jo të rekomandohet për kontratë.

Ju na keni diskriminuar neve si OE i përgjegjshëm edhe pse i plotësojmë të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë për të dyja lotet jemi shpallur si tenderues i pasuksesshëm.

Ne kemi parashtruar kërkesën për rishqyrtim me dt.16.10.2020, mirëpo deri më sot nuk kemi marr asnjë përgjigje. Për derisa ka kaluar afati prej 6 dite për të dhënë një përgjigje AK-ja dhe ne nuk kemi marr përgjigje, atëherë kemi qenë të detyruar të parashtrojmë ankesë në OSHP. Me këtë rast AK-ja ka shkelur nenin 108/A të LPP-së. Gjithashtu me këtë veprim të AK-së po vërtetohen edhe më shumë pretendimet tona ankimore, pasi që nëse pretendimet tona nuk do të ishin të bazuara atëherë AK-ja do të publikonte vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim duke e vërtetuar me fakte se nuk qëndrojnë pretendimet tona ankimore, mirëpo që një gjë të tillë nuk e ka bërë.

Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë rezulton se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë **tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët** sipas neni 60 paragrafi 1.1 i LPP-së.

Gjithashtu AK-ja nuk e ka respektuar edhe nenin 7 të LPP-së, duke na diskriminuar neve si operator ekonomik, edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë, nuk jemi shpallur fitues të këtij tenderi.

Gjithashtu autoriteti kontraktues nuk i ka respektuar edhe dispozitat e nenit 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke u bazuar në të gjitha faktet dhe dëshmitë që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP-ja që të lëshojë:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar ankesa e OE **"HAXHA KOM"**
ANULOHET, njoftimi mbi vendimin e AK-së për dhënie të kontratës për Lot 1 dhe 2 dhe lënda kthehet në **RIVLERËSIM,**
DETYROHET autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës:

Neve si Operator Ekonomik na janë bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, përgatitjen e kërkesave për rishqyrtim, ankesave etj. në vlerë prej 5,000.00 euro.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura
Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.
f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe
g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*